DALESE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-579/4
-01-
Data Datum Date 03.10.2024

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Izedin Bytyqi,** U. d Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | |
| Kopje: | Kryetar i Komunës së Gllogocit<br>Kryesuesi i KK-Gllogoc<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL | |
| Përmes: | **Jeton Qela**, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL | |
| Nga: | **Erblin Hetemi, U.d** Udhëheqës **i** Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë:01.10.2024<br>VI- 020-579 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës<br>2.Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse | **Xhevat Tafa** , Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br><br>**Vjosa Ahmetaj**, Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave | |
| Lënda: | Shkresë përcjellëse në MMPHI | |
| Lloji i aktit: | **Vendim** | |

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar: **Vendimin 02 Nr. 400/01-46222 për ndarjen e parcelës kadastrale 326-4 Çikatovë e Re, i** nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Gllogocit, me qellim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 3, të Rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

**Vendimin 02 Nr. 400/01-46222 për ndarjen e parcelës kadastrale 326-4 Çikatovë e Re**

**I miratuar më datë: 19.09.2024**
**I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 20.09.2024**

**Republika e Kosovës**
Komuna e Drenasit (Gllogoc)
Kuvendi i Komunës
02 **Nr.** 40/01-4622 **dt.** 19/09/ **2024**

Bazuar në nenin 11,12,dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe kërkesës për ndarje nr.06-070/01-22711 të dt.13.05.2024. Kuvendi i Komunës së Drenasit (Gllogoc) në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë: 19.09.2024, miratoi këtë

INCOMING
Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data: 20.09.2024
Njësia organizative: 04 | Nr. i Lëndës: 010-579 | Vlera:

## VENDIM

**Për ndarjen e parcelës kadastrale 326-4 Çikatovë e Re**

**Neni 1**

Me këtë vendim, kërkohet miratimi i ndarjes së parcelës kadastrale në Çikatovë e Re, me qëllim të realizimet të projektit për ndërtimin e ndërtimit të objektit për persona me aftësi të kufizuar (prapambetje mendore).

**Neni 2**

Parcela që kërkohet të ndahet, është si më poshtë:

- Parcela kadastrale Nr.326-4 me sip.42991 $m^2$ zona kadastra le Shtrubullovë, propozohet që të bëhet ndarja e kësaj parcele kadastrale, ku prej sipërfaqes së përgjithshme të ndahet sipërfaqja S=2500 $m^2$.

**Neni 3**

Qëllimi i ndarjes së parcelës kadastrale 326-4 në zk.Çikatovë e Re, bëhet për t'i hapur rrugë ndërtimit të objektit për persona me aftësi të kufizuar (prapambetje mendore).

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

**Neni 5**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i mbledhjes të KK
Gani Krasniqi

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit
- Palës

# A R S Y E T I M

Në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L – 048 ,Komuna e Drenasit obligohet të miratoj ketë propozim- vendim, me qëllim të ndërtimit të shtëpisë se komunitetit për persona me aftësi te kufizuar (SHKPAK), në Zonën Kadastrale Çikatovë e Re, kërkohet që të bëhet ndarja e parcelës kadastrale 326-4 si më poshtë:

Për të realizuar ndërtimit të objektit për persona me aftësi të kufizuar (prapambetje mendore), në zonën kadastrale Çiaktovë e Re, nevojitet një sipërfaqe prej 2500 $m^2$, prandaj edhe do të bëhet ndarja e parcelës 326-4, ku nga sipërfaqe e përgjithshme e kësaj parcela do të ndahet sipërfaqja prej 2500 $m^2$.

Bashkangjitur i gjeni:

- Certifikatën mbi të drejtat e pronësisë
- Kopjen e planit dhe
- Skicën e propozuar për ndarje.
- Buxhetin e ndara për ketë investim